



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljezi/Prodato Received/Delivery		03.11.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Pril Nr Pril Pril No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKAMSHICK	6698/2022		1/10	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.773/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.773/2022 të datës 06.09.2022 të parashtruar nga ankuesi [ ] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [ ] me adresë rruga [ ] kundër Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.773/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 1334/2022 i datës 22.08.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të kujdeset për zbatimin e vendimit si në pikën II.

IV. Detyrohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e të njëjtit duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me Nr. 332 të datës 07.05.2018 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për të Huaj", në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 24.06.2022 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore lidhur me shkelje të rënda të detyrave të punës si: Cenim i nëpunësve civil, përdorim i alkoolit në vendin e punës dhe shfrytëzimin i dokumenteve zyrtare jashtë kompetencave ligjore.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 24.06.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 1025/2022 përmes të cilit ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit deri në një vendim tjetër, ndërsa më datë 21.07.2022 po i njëjti komision ka nxjerr Vendim me Nr. 1153/2022 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit në procedurë administrative për 30 ditë kalendarike për shkak të kompleksitetit të lëndës.

Ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 22.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 1334/2022 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinorë "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare".

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të tij, më datë 06.09.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:5178/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.09.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli, me datë 27.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, sipas kërkesë së Kryetares së Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2022 ka nxjerr Vendim VK.Nr.126/2022 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendimmarrje për ankesën e ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 06.09.2022 me Nr. Prot:5178/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 04.08.2022; Vendimin A.nr.409/2022 i datës 03.06.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 990/2022 i datës 23.06.2022 i Menaxherit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Njoftimin për pezullim nga detyra i datës 24.06.2022 nga Personeli MPB për ankuesin; Njoftimin për inicimin e procedurës disiplinore datë 24.06.2022 nga Personeli MPB për ankuesin; Vendimin me Nr.1025/2022 i datës 24.06.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme për pezullimin nga detyra të ankuesit; Vendimin me Nr. 1153/2022 i datës 21.07.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtyrje të afatit në procedurë administrative; Vendimin me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Mesazh telefoni nga ankuesi për [redacted] i datës 08.10.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.09.2022; Parashtrësën e ankuesit e datës 07.09.2022 me Nr. Port:5204/2022; Emailin e datës 07.10.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 07.10.2021 nga ankuesit për kolegjet; Emailin e datës 06.10.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 07.10.2021 nga ankuesin; Emailin e datës 07.10.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Përgjigjen në ankesë e datës 27.09.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me Nr. 332 i datës 07.05.2018 në emër të ankuesit; Njoftimin përmes emailit i datës 01.04.2022 nga [redacted] për [redacted] Kërkesën përmes emailit e datës 29.03.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 29.03.2022 nga [redacted] për [redacted] Kërkesë për veprim urgjente përmes emailit e datës 23.06.2022 nga SSHCK për Deklaratë me Nr. 988 e datës 23.06.2022 nga Zyrtarët e Divizionit për të Huaj për Ministrin e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 653/2013 i datës 15.08.2013 për miratimin e listës së informacioneve të prodhuara nga MPB si dhe niveli i klasifikimit të këtyre informacioneve; Lista e informacioneve të prodhuara nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe niveli i klasifikimit të këtyre informacioneve; Vendimin me Nr. 785/2013 i datës 01.10.2013 për miratimin e listës së pozitive zyrtare (ex officio) si dhe nivelit i verifikimit të cilët duhet ti nënshtrohet procesit të verifikimit për pajise me leje të sigurisë; Lista a pozitive zyrtare (ex officio) si dhe nivelit i verifikimit të cilët duhet ti nënshtrohet procesit të verifikimit për pajise me leje të sigurisë; Ftesë për seancë publike e datës 30.09.2022 për Përfaqësuesin e ankuesit, ankuesin, Sekretaren e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Udhëheqësin e Divizionit të Burimeve Njerëzore; Emailin e datës 30.09.2022 për [redacted] dhe [redacted] nga [redacted] lidhur me ftesën për seancë; Procesverbalin e seancës dëgjimore i datës 18.10.2022. Vendimin VK.Nr.126/2022 i datës 25.10.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të

Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shtyrjes së afatit të vendimmarrjes për 30 ditë tjera ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka dhënë arsytet se cili ka qenë kompleksiteti i lëndës. Komisioni Disiplinor në vendimin e datës 22.08.2022 ka dështuar të bëjë dallimin ndërmjet shfrytëzimit dhe posedimit të dokumenteve ligjore, sepse ankuesi në momentin që ka pranuar vendimin për transferim ka ndërmarr veprimet për dorëzimin e detyrës dhe dosjeve mirëpo që nuk ka marr asnjë përgjigje nga menaxhmenti i MPB-së, andaj të gjitha konstatimet në këtë vendim janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar-analizuar kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit për mbajtje të seancës publike në lidhje me këtë ankesë, ka konstatuar se është e arsyeshme që të mbahet seanca publike me qëllim që të sqarohen disa fakte kontestuese që janë në mesë palëve në procedurë, nga se përmes formës së dëgjimit-ballafaqimit-sqarimit të palëve mund të nxjerrën përfundime adekuate nga ana e kolegjit që mund të jenë me rëndësi përmbajtësore me rastin e nxjerrjes së vendimit meritator, andaj bazuar në nenin 16 paragrafi 5 ku parashihet se: *"5.....Në rast të kontestit lidhur me faktet materiale, të dy palëve u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje nga Këshilli, me qëllim të paraqitjes së provave dhe dëshmiave përkatëse"*, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kolegji më datë 06.10.2022 ka mbajt seancë dëgjimore duke ftuar ankuesin, përfaqësuesin e autorizuar të tij, Sekretaren e Ministrisë së Punëve të Brendshme si inicuese e procedurës disiplinore si dhe Udhëheqësin e Divizionit të Burimeve Njerëzore si Njësi Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në kuadër të organit të punësimit, si palë relevante në këtë procedurë, të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt, mirëpo përveç ankuesit dhe përfaqësuesit të tij që kanë qenë prezentë në seancë, palët nga organi i punësimit përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë marr pjesë në seancë, përkundër që janë ftuar në mënyrë të rregullt por mungesën e tyre në seancë nuk e kanë arsyetuar, dhe se nuk kanë adresuar ndonjë kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore, ndërsa kolegji ka vlerësuar se me qenë se nuk ka pasur ndonjë kërkesë për shtyrje të seancës atëherë e njëjta ishte mbajtur.

Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket shtyrjes së afatit të vendimmarrjes në procedurë administrative për 30 ditë kalendarike nga ana e komisionit disiplinor, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Rregullorja (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht neni 12 paragrafi 6, ka përcaktuar se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njëjta për burime njerëzore"*, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme bazuar në nenin 99 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: *"1.Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji"*, mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë

21.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 1153/2022 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit në procedurë administrative edhe për 30 ditë kalendarike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sa i përket këtij pretendimi ankimor, sa i përket shtyrjes së afatit të vendimmarrjes nga komisioni disiplinor kishte vendosë për përfundim të procedimit administrativë sipas ankesës A.nr.672/2022 të datës 27.07.2022 sipas vendimit A.nr.672/2022 të datës 02.09.2022 për faktin se tashmë objekti i vendimmarrjes ishte bërë i pamundur për faktin se ishte vendosë në mënyrë meritore në lidhje me rastin dhe tashmë objekti i ankesës ishte konsumuar si proces në kuadër të kësaj procedure sepse me datën 22.08.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr vendimin Nr.1334 i cili ka vendosë për çështjen kryesore që ka qenë objekt i procedurës disiplinore me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr.1025/2022 të datës 24.06.2022 që ka qenë objekt i ankesës për pezullimin e ankuesit nga pozita e Udhëheqësit të Divizionit për të huaj në kuadër të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion, dhe si të tillë në përmbajtje Kolegji nuk ishte lëshuar në vlerësim të ligjshmërisë së vendimit, Kolegji mbi arsyet e mësipërme konstaton se me qenë se tashmë nga Këshilli ishte vendosur sipas Vendimit A.nr.672/2022 të datës 02.09.2022 në lidhje me shtyrjen e afatit nga ana e Komisionit Disiplinor atëherë nuk është lëshuar në vlerësim të ligjshmërisë së këtij vendimi pasi është konsumuar elementi i shqyrtimit të ligjshmërisë së të njëjtit dhe në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se për dy nga tri shkeljet e supozuara se janë kryer nga ana e ankuesit për të cilat ka filluar procedura disiplinore, konkretisht *Cenim i nëpunësve civil dhe përdorim i alkoolit në vendin e punës*, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022, i ka refuzuar këto pretendime me arsyetimin që inicuesi i procedurës disiplinore nuk ka dëshmuar me fakte dhe prova konkrete se ekzistojnë shkeljet e tilla të pretenduara në kërkesë për inicim të procedurës disiplinore po ashtu nuk janë dëshmuar as nga dëshmitarët që ankuesi ka bërë shkelje të tilla për çka është ngarkuar.

Sa i përket ligjshmërisë së Vendimit me Nr.1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të kontestuar me ankesë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit "*Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare*", është bërë me arsyetimin se është përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave të punës për shkak se në momentin që është transferuar në një pozitë tjetër ka marrë edhe dosjen e gjashtë (6) shtetasve të huaj turq në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi fillimisht sipas Vendimit me Nr. 724 të datës 06.10.2021 të Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme është transferuar përkohësisht duke filluar nga data 07.10.2021 deri më datë 06.04.2022 nga pozita

Udhëheqës i Divizionit për të Huaj në pozitën Udhëheqës i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve. Ankuesi nga data 07.10.2021 sipas vendimit të lartcekur ka qenë i obliguar që të liroj zyrën e tij, ndërsa ankuesi më datë 07.10.2021 përmes emailit të dërguar për \_\_\_\_\_ dhe ka njoftuar se: "Dje në fund të orarit të punës, pa paralajmërim ka pranuar në email vendimin për transferim të përkohshëm. Meqë ky vendim është bërë pa konsultimin tim paraprak, pa pëlqim dhe pa ndonjë arsye të veçantë, atëherë ju lutem nëse keni mundësi dhe nga përgjegjësit vendimmarrëse të më jepni një sqarim: Cikla është arsyeja e këtij transferi?. Gjithashtu në afatin kohor të cilin e keni cekur në këtë vendim, ju njoftoj se sot më duhet të bëjë pranim-dorëzimin e detyrës dhe nuk di kujt duhet t'ia dorëzoj. Po ashtu në aspektin teknik/logjistik sot më nevojitet më shumë kohë që ti mbledh gjerat e mia për ti mbyll proceset e qasjeve të cilat i kam në bazat e ndryshme të të dhënave dhe aspekte tjera të cilat më duhet ti bëjë me IT të Policisë, IT nga MPJ dhe nga MPB", ndërsa në të njëjtën ditë ankuesi ka njoftuar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejt se: "...ju lutem më njofto se kush është personi i autorizuar që ti dorëzoj detyrën së bashku me procesverbal për materialin përcjellës, inventarin, arkiven dhe gjërat e tjera me të cilat jam i ngarkuar... sepse në bazë të vendimit obligohem që sot me datë 07.10.2021 ta zbatoj", mirëpo mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesi përmes emailit të datës 07.10.2022 ka kërkuar nga \_\_\_\_\_ se te kush duhet ta bëjë pranim/dorëzimin e detyrës pasi nuk është caktuar ende askush që ta bëjë pranimin e detyrës së re". Nga provat e lëndës, ankuesi nuk ka marr asnjë përgjigje të vetme lidhur me kërkesat e tij, ndërsa më datë 08.10.2021 përmes VIBER-it ka njoftuar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejt se: "senet e mia i mora, dosjet i shpërndava te zyrtarët dhe qelsin e zyrës e lash ne tavolinë te zyrtarët qanej. Inventarin e këto tjerat qysh jon kan ashtu i lash".

Siç përmendet edhe në Vendimin me Nr.1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi përmes emailit të datës 22.03.2022 i është kërkuar që të njoftoj lidhur me dosjet e shtetasve të huaj e të cilat dosje kanë qenë në zyrën e tij, ndërsa sipas provave të lëndës, ankuesi më datë 29.03.2022 ka sjell folderin me dosjet e gjashtë (6) shtetasve të huaj turq.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 06.10.2022, ankuesi dhe përfaqësuesi i ankuesit kanë deklaruar se divizioni ku e mban pozitën e përhershme dhe në vendin ku është transferuar janë në kuadër të të njëjtit Departament, dhe në rastin e transferimit dhe pas përpjekjeve përmes emaileve për të bërë pranim/dorëzimin e detyrës dhe materialeve, meqë është dashur të lirohet zyra për shkak të transferimit, atëherë i kam marr materialet që kam vlerësuar se më përkasin mua por pa e ditur që kam marr edhe dosjet e gjashtë (6) shtetasve të huaj turq dhe të njëjtat nuk janë hapur por kanë qëndruar në zyrën time, sepse nuk kam qenë i vetëdijshëm që kam marr ato dosje dhe në momentin që është konstatuar se ato dosje gjenden aty i kam kthyer dhe nuk ka munguar asnjë dokument dhe nga askush nuk është kontestuar, duke potencuar që deri sa e ushtron këtë pozitë nuk pasur ndonjë vërejtje apo ankesë në lidhje me punën e tij.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022, nuk ka arritur që në mënyrë të drejtë të shqyrtoj faktet dhe

provat mbi bazën e të cilave i është shqiptuar masa disiplinore ankuesit, sepse ankuesi dosjet e gjashtë (6) shtetasve të huaj turq i ka pasur në zyrë të tij edhe para transferimit dhe cilësimi *"shfrytëzimi/posedimi i dokumenteve zyrtare jashtë kompetencave ligjore"* si në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore si në vendimin e kontestuar është i paqëndrueshëm, sepse më asnjë fakt apo argument nuk është konstatuar që ankuesi këto dokumentacione i ka shfrytëzuar për qëllime të tjera jashtë asaj zyrtare, dhe këto rrethana u trajtuan në seancë dëgjimore dhe ishin trajtuar mjaftueshëm edhe shkresat e lëndës përkundër që organi i punësimit nuk ka marrë pjesë në seancë dhe në këtë mënyrë me qenë se nuk kemi marrë ndonjë argumentim shtesë nga organi i punësimit që vërtetojnë të kundërtën e këtij konstatimi, andaj Kolegji duke marrë për bazë të gjitha shkresat e lëndës si dhe rrethanat tjera të potencuara si më lartë konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar nga se me asnjë provë nuk ka arrit organi i punësimit të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe të argumentojë bazën ligjore, rrjedhimisht mbi bazën e asaj që u konstatua më lartë masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor e që është objekt i kësaj ankese nuk ka mbështetje ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi dokumentacionin në fjale e ka poseduar në zyrën e tij para transferimit, rrjedhimisht të njëjtat dosje i ka poseduar në zyrën e tij edhe pas transferimit, kështu që të njëjtat nuk janë bartur diku tjetër përkatësisht nga kjo zyrë derisa janë kërkuar nga institucioni dhe se nga organi që ka pranuar këto dosje nga ankuesi është konfirmuar se nuk mungon asnjë dokumentacion në këto dosje dhe se janë kthyer të kompletuara dhe ky është një argument më shumë se nuk kemi shkakim të ndonjë pasojë në këtë rast, dhe rrjedhimisht mbi bazën e këtyre arsyeve të potencuara më lartë ankuesi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, dhe në këtë kuptim pretendimi ankimor mbi këto elemente është i bazuar.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme të elementeve të përgjegjësive disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*. Kolegji i këshillit konstaton se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nga komisioni disiplinorë *"Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare"* nuk janë marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 50 që rregullon parimet e individualizimit të masave disiplinore, përkatësisht paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 ku specifikisht potencohet se: *"1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në:....1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit të këtij ligji"*, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësia disiplinore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, konstaton se komisioni disiplinor me rastin e trajtimit të këtij rasti nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat që kanë qenë objekt i trajtimit, rrjedhimisht me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: "1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore", po ashtu ndërlidhur me nenin 12 paragrafi 5 Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative", Komisioni Disiplinor përmes shqiptimit të masës disiplinore përmes këtij vendimi të atakuar me këtë ankesë nuk ka përmbushur obligimet ligjore dhe procedurale administrative të përcaktuara në Ligjin për procedurën e Përgjithshme Administrative të përcaktuara si më lartë në disa pjesë të arsytimit të vendimit të kontestuar me këtë ankesë si dhe ato të përcaktuara qartë në nenin 12 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1; 3.2; 3.3 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "Merr në pyetje ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; Rishikon dokumentacionin përkatës; Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes", komisioni disiplinor bazuar në këto dispozita ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3; 1.4; 1.5 dhe 1.6 ku përcaktohet: ".....1.3.Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim", me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: "2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", si dhe në kundërshtim me nenin 88 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: "1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen", nenin 90 paragrafi 2 të njëjtit ligj ku parashihet: "2. Sigurimi i provave mund të bëhet në cilëndo fazë të procedurës, qoftë edhe para fillimit të saj. Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative", në këtë kuptim Komisioni Disiplinor nuk ka ndërmarr veprimet administrative për të vërtetuar saktë gjendjen faktike siç obligohet me dispozitat e këtij ligji të specifikuar më lartë, dhe në këtë kuptim vendimi është i paligjshëm, ndërsa pretendimi i ankuesit është i bazuar .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga arsyet e potencuara më lartë, konstaton se Vendimi me Nr. 1334/2022 i datës 22.08.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme përveç shkeljeve të dispozitave materiale është nxjerr edhe si rezultat i shkeljeve procedurale, siç përcaktohet edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 ku



përcaktohet: "1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit" ,kështu që masa disiplinore është në kundërshtim edhe me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenin 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 13 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse ankuesi nuk ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 25 paragrafi 1 dhe nenit 30 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si rezultat i kësaj në raport me ankuesin përmes shqiptimit të masës disiplinore ndaj të njëjtit janë shkelur parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 të këtij ligji i cili përcakton se: "1.Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", andaj mbi këtë bazë të specifikuar më lartë shqiptimi i masës sipas vendimit të atakuar me këtë ankesë është e bazuar në prova që nuk janë të faktuara konform legjislacionit në fuqi të Shërbimit Civil dhe në këtë aspekt pretendimi ankimor është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në konstatimet e mësipërme, si në dispozitiv dhe në arsyetim të këtij vendimi, konstaton se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme janë të obliguar që të ndërmarrin veprimet administrative konform dispozitivit të këtij vendimi, që në pajtim me këtë vendim konform kompetencës specifike ligjore të bëjnë shuarjen e masës disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda, A.nr.773/2022, datë 03.11.2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Bekteshi*  
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK- së.